



Bazuar në dispozitat e nenit 108/A par. 1 dhe 3.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92-së dhe dispozitat nga neni 4 i Rregullave për parashtrim të ankesave – FO2, “Olti Trasing” Sh.p.k. Sheshi Bil Klinton Prishtinë – Republika e Kosovës në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit lidhur me këtë lëndë, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Njoftimit për Dhënie të Kontratës i publikuar me datë 13/03/2020; në web faqen e platformës elektronike të KRPP-së Kopje e VENDIMIT –

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit: Nr. 656 -19 – 9164 – 5- 1- 1 dhe

Nr. i brendshëm: 656 – 19 – 511

Sa i përket tenderit për: “Ndërtimi i qendrës multifunkcionale në Ferizaj – Projekt trevjeçar

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit*** “Olti Trasing” Shpk – Sheshi Bill Klinton, pn.- Prishtinë, Rep. e Kosovës

Komuna e Prishtinës
(Vendi)
038/ 500 893 mob. 044 50 08 93

10000
(Kodi postar)

beni.dona@hotmail.com
(Adresa elektronike)

26/03/2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

E. Ragip Mustafa

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës.

- ☐ Njoftimi për Kontratë publikuar në web faqen e platëformës elektronike të KRPP-së dt. 03/12/2019;
- ☐ Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë 14/01/2020 ora 12:00, Komuna e Ferizajit Zyra e Prokurimit 70000Ferizaj Republika e Kosovës;
- ☐ Hapja e ofertave nga ana e komisionit të AK-së është bërë më datë 14/01 /2020 ora 12:00, Zyra e Prokurimit,
- ☐ Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – Dhënie të kontratë i publikuar në ueb faqen e platformes elektronike të KRPP-së me datë 13/03/2020;
- ☐ Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar me datë 13/03/2020;
- ☐ Kërkesë për sqarime të detajuara për arsyet e eliminimit me datë 13/03/2020 – Paraqitja e mjeteve juridike Kërkesa për Rishqyrtim pranë Autoietit Kontraktues
- ☐ Nuk kemi pranuar përgjigje nga autoritti kontraktues Komuna e Ferizajit Zyra e Prokurimit 70000Ferizaj Republika e Kosovës;

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☒

Jo

☐

Është organizuar procesi i hapjes publike të ofertave. Asnjëri nga Operatorët Ekonomik të pranishëm në procesin e hapjes publike të ofertave nuk ka pasur vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Jemi njoftuar me Letër standarde për ofertuesin e eliminuar

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të dokumenteve të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i qendrës multifunkcionale në Ferizaj – Projekt trevjeçar me nr. të aktivitetit të prokurimit Nr. 656 -19 – 9164 – 5- 1- 1 dhe Nr. i brendshëm: 656 – 19 – 511 Ne në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar konsiderojmë se shpallja e Njoftimit për dhënie të kontratës i publikuar në platformën elektronike të KRPP-së më 13/03/2020 nga autoriteti kontraktues - Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës është bërë në

kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe të gjitha aktet tjera nën ligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë e ka dëmtuar rëndë interesin material-financiar të kompanisë në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Shkeljet e dispozitave ligjore nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës; pas pranimit të Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues –aktivitetit të prokurimit i publikuar në ueb faqen e platformes elektronike të KRPP-së me datë 13/03/2020;

- Është shkelur neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi, shfrytëzimi më efikas, më transparent dhe më i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92;

- Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Barazia në trajtim – Jo diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

- Është shkelur neni 72 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

- Është shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

- Është shkelur neni 40 i RRUOPP-së (Krijimi i Komisioneve Velersuese të tenderve). –paragrafi 40.13

- Është shkelur neni 41 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

- Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Barazia në trajtim – Jo diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,

- Është shkelur neni 72 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92;

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Në letër standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 13/03/2020 në sqarim shkruan: “X Nuk keni përmbushur Kërkesat mbi kapacitetin ekonomik financiar dhe kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”.

Me tutje në ARSYETIM

Tenderi i juaj është refuzuar për këto arsye:

- Nuk keni përmbushur:

2. Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale duke u bazuar në kërkesat në dosjen e tenderit.

3. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale – Kapaciteti teknik dhe professional duke u bazuar në kërkesat në dosjen e tenderit.

Me datë 13/03/2020 përmes platëformes elektronike të e-prokurimit jemi njoftuar se me kontratë publike për aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Qendrës Multifunkcionale në Ferizaj – projekt trevjeçar është propozuar që të shpërblehet me kontratë oferta e Grup operatorëve ekonomik “B – BARDHI” SH. P. K. ; “Linda”; “EURO -

INFRASTRUKTURA” , Ferizaj 70000 Ferizaj

Si duket në pikën 2 gabimisht e keni shkruar 2. Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale duke u bazuar në kërkesat në dosjen e tenderit, sepse fare nuk ka të bëjë me te që ju e keni shkruar.

- Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92

Paragrafi 1 këtij neni thotë:

1. “Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”.

Për shkak të arsyetimeve të cekura më lartë i propozojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së pas shqyrtimit të kësaj ankese si dhe pas konstatimeve të ekspertit shqyrtues të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që me kontratë publike për aktivitetin e lartcekur të prokurimit të shpërblehet oferta e Operatorit Ekonomik “Olti Trasing” Sh.p.k. Sheshi Bil Klinton Prishtinë ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët që plotëson të gjitha kriteret e specifikuar në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2016,2017 dhe 2018), ku kërkohet që qarkullimi i OE ose grupit të jetë jo më pak se 4,500,000.00 euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të çertifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2016,2017 dhe 2018) (të bashkëngjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit).

“Noterzimi i licences se auditorit është kopje – jo original siç është kërkuar në DT”.

Licenca e auditorit është e noterizuar me datë18/04/2017 dhe është e vlefshme deri më 31/05/2020.

Provë: noterizimi LRP. Nr. 4628 /2017

<p>Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje nje vlere per punet e kryera jo me pak se 4,500,000.00 €.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> 1.Lista e kontratave (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroj listen e kontratave te realizuara gjate tri viteve te fundit nga data e njoftimit per kontrate te ketij tenderi ne origjinal, te nenshkruar dhe vulosur nga OE, te deshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te puneve te kryera ne lemin e puneve te ngjashme (objekte ndertimore dhe instalime ne objekte ndertimore), te cilat tregojne vleren, daten.</p>
<p>Stafi profesional Menaxher i projektit. 1.Inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - konstruktiv.</p>	<p>Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–original) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. Menaxheri i projektit te deshmohe me nje deklarate nga OE.</p>
<p>2.Nje inxhinier i diplomuar i Arkitektures (ose master)</p>	<p>2.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–original) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.</p>
<p>3.Një inxhinier i Gjeodezisë (bachelor ose master) - te licencuar.</p>	<p>3.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–original) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.</p>
<p>4.Një inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - hidroteknike.</p>	<p>4.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–original) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.</p>
<p>5. Një inxhinier i diplomuar I Elektroteknikes (ose master)</p>	<p>5.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–original) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.</p>
<p>6. Një inxhinier i diplomuar i Makinerise (ose master).</p>	<p>6.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–original) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.</p>
	<p><i>Të gjitha diplomat për stafin profesional duke filluar nga numri rendor një (1) deri në numrin rendor gjashtë (6) për të cilat ju potenconi në letër standarde për tenderuesin e eliminuar se noterizimi i diplomave është kopje - jo original siç është kërkuar në DT, nuk qendrojnë, sepse të gjitha diplomat e stafit profesional janë të noterizuara nga origjinali.</i></p> <p><i>Provë: Diplomat e noterizuara nga noteri i autorizuar</i></p>

<p>7. Lista e mjeteve te punës dhe ate se paku - 5 eskavator, - 6 kamion kiper, - 1 kamion per transport - 5 kamioneta per transport - 1 cilinder (vibrues), - 1 Skip me rrota me lopate para dhe krah mbrapa - 1 Pirnuniç për ngarkim-shkarkim 1- Damper 1- Korpë hidraulike se paku 10 metra lartësi ngritëse - 1 grejder, -1 Autobetonjere e vogel 1- Autocisterrnë për ujë - 1 Vinç statik për ndërtimtari, - Skele ndërtimi së paku 2500m2.</p>	<p>7. Lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për keto automjete duhet të ofroj listën e mjeteve të punës të nënshkruar dhe vulosur në origjinal të deshmuar me librezë të regjistrimit valide, fature për blerjen (me deshmi pagese), dëd doganor në emër të kompanisë me të cilën konkuron ose grupit të operatorëve ekonomik të cilët konkurojnë.</p> <p><i>Përgjigje:</i> <i>Lista e mjeteve të punës është e kompletë ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit për aktivitetin e latëkur të prokurimit.</i></p> <p><i>Provë:</i> <i>Komplet lista e mjeteve të punës ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit, të gjitha të shoqëruara me marrëveshjet përkatëse për bashkëpunim me secilin antar me të cilin kemi bërë marrëveshje për krijimin e grupit të operatorëve ekonomik së bashku me tender janë dorëzuar përmes platformës së e-prokurimit.</i></p>
--	---

Duke pasur para syshë se autoriteti kontraktues Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës fare nuk n aka kthye përgjigje në kërkesen tone për rishqyrtim të cilen e kemi parashtruar në afatin e paraparë ligjor jemi të detyruar që të parashtrojmë këtë ankesë

Prandej duke konsideruar se sqarimet të cilat i kemi dhënë në Kërkesë për Rishqyrtim janë të mjaftueshme që të formoni një komision të ri për ri-vlerësim dhe të bëni përsëri ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, pasi komisioni ri-vlerësues të ketë konstatuar se oferta e jonë është ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët të propozoni që me kontratë publike të shpërblehet oferta e Grup operatorëve ekonomik Olti Trasing SH. P. K.; SINANI ING SH.P.K.; Beni Dona Plast SH.P.K. 10000 Prishtinë. Siç shihet nga vendimet e ankimuara AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave ligjore të lartshënuara të LPP-së dhe akteve tjera nënligjore që si pasojë nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me dëmtimin e Operatorit Ekonomik "OLTI TRASING SH. P. K. Prishtinë kërkojmë nga AK Drejtoria e prokurimit Zyrtari Përgjegjes i Prokurimit të formojë një komision për trajtimin e Kërkesës tonë për Rishqyrtim për aktivitetin e lartcekur të prokurimit dhe pas shqyrtimit dhe marrjes në konsideratë si dhe duke iu dhënë peshë të gjitha fakteve të paraqitura në ankesë - kërkesë për Rishqyrtim dhe pas veprimeve korrigjuese, i propozojmë të merr këtë:

V E N D I M

- **MIRATOHET** si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik Grup operatorëve ekonomik Olti Trasing SH. P. K.; SINANI ING SH.P.K.; Beni Dona Plast SH.P.K. 10000 Prishtinë.
- **ANULOHE**T Vendimi, përkatësisht Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – dhënie e kontratë për aktivitetin e latëcekur të prokurimit i publikuar në ueb faqen e platëformës elektronike të KRPP-së me datë 13/03/2020.
- Të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që me kontratë publike për aktivitetin e lartcekur të prokurimit të shpërblehet oferta e Operatorit Ekonomik Grup operatorëve ekonomik Olti Trasing SH. P. K.; SINANI ING SH.P.K.; Beni Dona Plast SH.P.K. 10000 Prishtinë. si ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët që plotëson të gjitha kriteret e specifikuar në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale janë të konsiderueshme që kanë të bëjnë me përgatitjen e dosjes së tenderit:

Përgatitja e Kërkeses për Rishqyrtim,

Përgatitja Ankesës,

Dëmet më të mëdha do t'i shkatohen Operatorit Ekonomik "Olti Trasing" Sh.p.k. Sheshi Bil Clinton Prishtinë nëse oferta nuk do të shpërblehet me kontratë publike për aktivitetin e lartëcekur të prokurimit.

Të gjitha dëmet materiale do të konstatohen në të ardhmën nga ekspertët e autorizuar ligjorë përkatës gjatë zhvillimit të procedurës.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë";
- b) Një kopje të procesverbalit të hapjes së ofertave;
- c) Një kopje të Njoftimit për Dhënie të Kontratës i publikuar në ueb faqën e platformës elektronike të KRPP-së me datë 13/03/2020;
- d) Një kopje të Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 13/03/2020;
- e) Kopjen e kërkesës për sqarime- qasje në dokumente zyrtare të dërguar përmes postes elektronike drejtuar Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës;
- f) Si dhe të gjitha korrospodencat të cilat janë zhvillu prej Autoritetit Kontraktues dhe Operatoreve Ekonomik.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*